REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR

TIRANË

NR. 687 AKTI **Data 06.09.2018**

V E N D I M

"Për pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me trup gjykues të përbërë prej:

GJYQTAR: ERJON BANI

Sot më datë 06.09.2018 mori në shqyrtim në dhomë këshillimi,[1] pa pranë e palëve dhe të sekretarisë gjyqësore, çështjen penale me Nr. 687 Akti, me palë:

KËRKUES: **Artan Muça,** i biri i Hajriut dhe i Selfie, i datëlindjes 20.05.1966, lindur në Sarandë dhe banues në Tiranë, me shtetësi shqiptare, gjendja gjyqësore *"I dënuar"*, me arsim të mesëm, përfaqësuar me prokurë të posaçme lëshuar më datë 10.07.2018 nga **Av.Mikel Cipi**, me Nr. Licence 9117 anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë.

OBJEKTI: Rishikimi i vendimit penal Nr. 1418, datë 02.11.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 450 e vijues të K.Pr.Penale, neni 43 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 2/1 të Protokollit Nr. 7, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe vendimin Nr. 354, datë 28.07.1999 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

VËREN

I. Rrethanat e çështjes.

1. Kërkuesi, **Artan Muça**, më datë 17.07.2018 ka paraqitur pranë kësaj Gjykate, kërkesën penale me objekt: Rishikimi i vendimit penal Nr. 1418, datë 02.11.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

[1] Në nenin 112 pika 4 të K.Pr.Penale nën titullin **"Format e disponimit të gjykatës"** parashikohet shprehimisht se: "*4. Vendimi merret në dhomën e këshillimit, pa praninë e sekretarit dhe të palëve.".*

[shqiptaria.com]

2. Gjatë gjykimit rezultoi se, me Vendimin Nr. 1418, datë 02.11.2010 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur: *"Deklarimin fajtor të të pandehurit **Artan Hajri Muça**, për veprën penale të "Mashtrimit që ka sjellë pasoja të rënda", dhe në bazë të neneve 143 paragrafi i dytë, e 49 të Kodit Penal, dënimin e tij me 10 (Dhjetë) vjet burgim. Vuajtja e dënimit fillon ditën e ekzekutimit të këtij vendimi duke u ekzekutuar në një burg të sigurisë së zakonshme. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të pandehurit. Kundër këtij vendimi lejohet ankim, në gjykatën e Apelit Tiranë brenda 10 ditëve nga e nesërmja e shpalljes. – **U shpall në Tiranë, sot më datë 02.11.2010"**.* Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 12.11.2010. Duke qenë se kërkuesi Artan Muça nuk është gjendur është bërë njoftimi me shpallje dhe i gjithë procesi gjyqësor është zhvilluar në mungesë të tij, duke iu caktuar një avokat kryesisht në zbatim të nenit 49 të K.Pr.Penale. Pra, kërkuesi nuk ka pasur dijeni personalisht për procesin. Ky fakt provohet me procesverbalin e senacës gjyqësore të datës 21.09.2010. Ndodhur në këto kushte, kërkuesi duke qenë se është gjykuar në mungese të tij pa pasur dijeni për procesin, si dhe duke qenë se pasi është dënuar kanë ndryshuar dispozitat ligjore për nenin 143 të Kodit Penal që përbën një fakt të ri, kërkon rishikimin e vendimit të formës së prerë të dhënë në mungesë të tij.

3. Mbështetur në rrethanat e mësipërme si dhe duke pasur parasysh ndryshimet ligjore të bërë në nenin 450 e vijues të K.Pr.Penale me ligjin Nr. 35/2017, Gjykata në dhomë këshillimi krijoi bindjen se togëfjalëshi ***"****nga gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin në dhomën e këshillimit"* parashikuar në pikën 1 të nenit 453 të K.Pr.Penale si dhe togfjalëshin *"...i së njëjtës gjykatë"* parashikuar në pikën 3 të nenit 453 të K.Pr.Penale, të ndryshuar me Ligjin Nr. 35/2017, bie në kundërshtim me nenin 4, 34, 116, 135 dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në këto kushte, Gjykata vlerësoi se gjykimi i çështjes duhet të pezullohej, në bazë dhe për zbatim të nenit 145/2 të Kushtetutës, duke vendosur të nisë procedurën e kontrollit incidental të kushtetutshmërisë së dispozitës ligjore të individualizuar, duke ia referuar kështu çështjen Gjykatës Kushtetuese.

II. Vlerësimi i Gjykatës.

1. Lidhur me legjitimimin e gjykatës referuese.

4. Neni 134/d i Kushtetutës i jep të drejtën çdo gjykate të Republikës së Shqipërisë të ketë legjitimitet formal për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, megjithëse kjo dispozitë blankete dhe referuese të çon në nenin 145 të Kushtetutës. Kjo e fundit disponon se "*1. Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. 2. Kur gjyqtarët çmojnë se vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin, dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për të gjitha gjykatat.*" Për të konkretizuar dhe detajuar më tej institutin e kontrollit incidental të kushtetutshmërisë, në nenin 68 të Ligjit Nr. 8577, datë 10.02.2000 "*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, nën titullin "**Vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese"** parashikohet shprehimisht se: *"1. Kur gjykata ose gjyqtari gjatë një procesi gjyqësor dhe në çdo kohë, **kryesisht** ose me kërkesë të palëve, çmon se ligji është antikushtetues dhe kur ka lidhje të drejtpërdrejtë midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete, nuk e zbaton atë, duke vendosur pezullimin e shqyrtimit të mëtejshëm të çështjes dhe dërgimin e*

Shqiptaria.com

*materialeve të saj Gjykatës Kushtetuese, për t'u shprehur për kushtetutshmërinë e ligjit***.** *2. Në vendimin e saj gjykata apo gjyqtari duhet të përcaktojnë dispozitat e ligjit që ata çmojnë se janë të papajtueshme me normat konkrete ose parimet e tjera të Kushtetutës, të cilat ligji nuk i ka respektuar ose i ka cenuar, si dhe shkaqet për të cilat kërkohet shfuqizimi i tij.".*

5. Në jurisprudencën e saj Gjykata Kushtetuese në trajtimet *in abstracto* por edhe *in concreto* të kontrollit incidental kushtetues ka kristalizuar disa kushte-premisa që duhet të plotësohen formalisht dhe proceduralisht në mënyrë të t'i jepet rrugë kontrollit incidental. Kështu, filimisht gjykata referuese duhet të përcaktojë apo të identifikojë ligjin apo normën konkrete ligjore që do të zbatohet në çështjen konkrete. Gjithashtu, gjykata referuese duhet të parashtrojë arsyet serioze që ka ajo ka vlerësuar se ligji apo norma është jokushtetuese, duke iu referuar normave dhe parimeve kushtetuese. Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar se, si kusht *sine qua non* për t'i dhënë rrugë gjykimit incidental, duhet detyrimisht të ketë një lidhje të drejtëpërdrejtë midis ligjit të dyshuar si jokushtetues dhe zgjidhjes së çështjes konkrete. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar se kontrolli incidental i ligjit apo i normës do të ketë mundësi të realizohet si mjet i fundit, në kuptimin që në rastin konkret nuk ka mundësi të realizohet një interpretim pajtues kushtetues të tyre.[2]

6. Duke u rikthyer në rastin konkret, Gjykata vlerëson se plotësohet kushtet për t'u legjitimuar në gjykimin kushtetues. Kështu, nga kërkuesi është paraqitur kërkesa për rishikimin e vendimit penal të formës së prerë. Në nenin 453 të K.Pr.Penale nën titullin "**Shqyrtimi i kërkesës"** parashikohet shprehimisht se: *"1. Kërkesa e rishikimit shqyrtohet* ***nga gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin në dhomën e këshillimit****, pa praninë e palëve..... Kur kërkesa pranohet, gjykata vendos dërgimin e çështjes për rigjykim* ***nga një tjetër trup gjykues i së njëjtës gjykatë*** *ose në gjykatën e apelit, kur kërkesa është bërë vetëm kundër vendimit të saj****. Kundër vendimit nuk lejohet ankim".*** Për pasojë kushtetueshmëria apo jokushtetueshmëria e togfjalëshit ***"****nga gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin në dhomën e këshillimit"* parashikuar në pikën 1 të nenit 453 të K.Pr.Penale si dhe togfjalëshit *"...i së njëjtës gjykatë"* parashikuar në pikën 3 të nenit 453 të K.Pr.Penale, të ndryshuar me Ligjin Nr. 35/2017, është element thelbësor i cili kushtëzon drejtpërdrejtë dhënien e një vendimi përfundimtar në lidhje me çështjen objekt gjykimi. Ashtu siç do të trajtohet më në detaje më poshtë, Gjykata vlerëson se për shkak të qartësisë së kësaj dispozite dhe praktikës tejet të konsoliduar gjyqësore nuk ekziston asnjë mundësi që kjo dispozitë të interpretohet në harmoni me dispozitat kushtetuese të cilat kjo gjykatë vlerëson se i cënon. Pra si përfundim gjykata vlerëson se plotësohet parakushti që kushtetutshmëria e normës së referuar të jetë *conditio sine qua non* për zgjidhjen e çështjes konkrete. Në lidhje me plotësimin e kushtit të dytë të parashtrimit të arsyeve serioze për jokushtetutshmërinë e këtij togfjalëshi, duke qenë se ajo përbën thelbin e kërkesës do ta trajtojë më poshtë.

2. Konsiderata të përgjithshme lidhur me insitutin e rishikimit.

[2] Shiko Vendimi Nr. 12, dt. 14.04.2010; Vendimin Nr. 2, dt. 03.02.2010; Vendimin Nr. 5, dt. 06.03.2009; Vendimi Nr, 11, dt. 27.05.2004; Vendimi Nr. 35, dt. 10.10.2007; Vendimi Nr. 18, dt. 23.04.2010; Vendimi Nr. 13, dt. 04.05.2009 i Gjykatës Kushtetuese.

[shqiptaria.com]

7. Gjykata çmon të trajtojë paraprakisht kuptimin e institutit të rishikimit të vendimeve penale të formës së prerë, për të konkluduar më pas nësë shkaqe e rishikimit të shtuara me ligjin Nr. 35/2017 janë shkaqe të mirëfillta rishikimi. Kështu, **rishikimi i vendimeve është një mjet i jashtëzakonshëm për goditjen e vendimeve penale që ka për qëllim rishikimin e çështjes së përfunduar me vendime të formës së prerë, për shkak se vendimi i gjykatës është i gabuar përsa i përket çmuarjes së faktit.** *(shiko vendimin unifikues Nr. 1, datë 31.01.2006 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë).* Ky gabim i të çmuarit të faktit sipas nenit 450 të K.Pr.Penale nën titullin "**Rastet e rishikimit"** ku parashikohet shprehimisht se: *"1. **Rishikimi mund të kërkohet:** a) kur faktet e vëna në themel të vendimit nuk pajtohen me ato të një vendimi tjetër të formës së prerë; b) kur vendimi është bazuar në një vendim të gjykatës civile ose administrative, i cili është revokuar më pas; c) kur pas vendimit kanë dalë ose janë zbuluar prova të reja, të cilat vetëm ose së bashku me ato që janë vlerësuar njëherë, tregojnë se vendimi është i gabuar; ç) kur vërtetohet se vendimi është dhënë si pasojë e falsifikimit të akteve të gjykimit ose të një fakti tjetër të parashikuar nga ligji si vepër penale..."*, duhet të rrjedhë ose për shkak se, nuk janë marrë parasysh në dhënien e vendimit rrethana të cilat nuk diheshin më parë prej gjykatës, por që dalin më vonë, të cilat sikur të diheshin, do t'i jepnin çështjes një zgjidhje të ndryshme, ose vërtetohet më pas se vendimi i dhënë është bazuar në dokumenta të fallsifikuara ose fakte që përbëjnë vepër penale. Gjykata çmon se karakteristikë e përbashkët e të gjitha shkaqeve të rishikimit të cituara më lartë, është fakti se vendimi penal, për të cilin kërkohet rishikimi është i gabuar jo për pakujdesi të gjykatës, pra për mosrespektim të së drejtës për një proces të parregullt të bërë prej saj, por për shkaqe të pavarura prej saj e që nuk diheshin në momentin e marrjes së vendimit.

7.1. Me ligjin Nr. 35/2017 janë shtuar dhe tre raste rishikimi parashikuar nga neni 450 i K.Pr.Penale, të cilat janë: "*1. **Rishikimi mund të kërkohet:**…d) kur shkaku për rishikimin e vendimit të formës së prerë rezulton nga një vendim i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut që e bën të domosdoshëm rigjykimin e çështjes. Kërkesa paraqitet brenda 6 muajve nga njoftimi i vendimit; dh) kur ekstradimi i të dënuarit të gjykuar në mungesë jepet me kushtin e shprehur të rigjykimit të çështjes. Kërkesa për rishikim mund të paraqitet brenda tridhjetë ditëve nga data kur personi është ekstraduar. Kërkesa e paraqitur brenda afatit nuk mund të refuzohet; e**) **kur personi është gjykuar në mungesë sipas nenit 352 të këtij Kodi dhe kërkon rigjykimin e çështjes. Kërkesa paraqitet brenda tridhjetë ditëve nga data e marrjes dijeni. Kërkesa e paraqitur brenda afatit nuk mund të refuzohet**."* Gjykata çmon se këto nuk janë raste të mirëfillta që përbëjnë thelbin e rishikimit si mjet i jashtëzakonshëm për goditjen e vendimeve penale që ka për qëllim rishikimin e çështjes së përfunduar me vendime të formës së prerë, për shkak se vendimi i gjykatës është i gabuar përsa i përket çmuarjes së faktit. Këto janë raste ***sui generis*** që synojnë rigjykimin nga e para të çështjes së përfunduar me një vendim të formës së prerë për shkak të cënimit të së drejtës së të pandehurit për një proces të rregullt ligjor, të konstatuar edhe nga ana e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, e cila udhëron në arsyetimin e saj që të rihapet procesi si mënyra më e mirë për të rivendosur të drejtën e shkelur. Rasti i parashikuar nga pika "dh"[3] e nenit 450 të K.Pr.Penale

[3] Shiko vendimin Nr. 232, datë 18.09.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ku thuhet shprehimisht se: *"Rishikimi i vendimit sipas përcaktimit që jep ky ligj në këtë rast do të kuptohet jo vetëm si mjet i jashtëzakonshëm ankimi ndaj vendimit të dhënë në mungesë, i cili zbatohet kur janë shterur të gjitha mjetet e tjera të ankimit, por në*

Ishdiplomaria.com

duhet parë në unitet me nenin 3 të protokollit të dytë shtesë të "Konventën Evropiane të Ekstradimit të 13 Dhjetorit 1957", të ratifikuar me Ligjin Nr. 8322, datë 02.04.1998, nën titullin **"Gjykimet në mungesë"** ku parashikohet shprehimisht se: *"1. Kur një Palë kontraktuese kërkon nga një Palë tjetër ekstradimin e një personi me qëllim ekzekutimin e një vendimi me burgim të dhënë në mungesë, pala e kërkuar mund të refuzojë ekstradimin për këtë qëllim, nëse sipas mendimit të tij, procedurat e gjykimit nuk përmbushin të drejtat minimale të mbrojtjes, të njohura për një person të akuzuar për një vepër penale.* ***Megjithatë, ekstradimi do të jepet nëse Pala kërkuese jep garanci të mjaftueshme që personi do të rigjykohet me të drejtën e mbrojtjes. Ky vendim do të autorizojë Palën kërkuese të ekzekutojë vendimin, nëse personi i dënuar nuk kundërshton një gjë të tillë, ose të nisë procedurat e rigjykimit për personin e ekstraduar***.".[4]

7.2. Gjithashtu, edhe pika "e" e nenit 450 të K.Pr.Penale parashikon rishikimin kur i pandehuri është gjykuar në mungesë pa pasur dijeni personalisht për procesin e zhvilluar në ngarkim të tij. Pra, Gjykata konstaton se në këto raste kemi të bëjmë cënimin e së drejtës së të pandehurit për një proces të rregullt nga ana e gjykatave duke i mohuar të drejtën e mbrojtjes efektive dhe parimin e kontradiktoritetit dhe jo thjesht me një çmuarje të gabuar të faktit, për shkak se, nuk janë marrë parasysh në dhënien e vendimit rrethana të cilat nuk diheshin më parë prej gjykatës, por që dalin më vonë, të cilat sikur të diheshin, do t'i jepnin çështjes një zgjidhje të ndryshme, ose vërtetohet më pas se vendimi i dhënë është bazuar në dokumenta të fallsifikuara ose fakte që përbëjnë vepër penale, që përbëjnë thelbin e insitutit të rishikimit të një vendimit të formës së prerë. Pandaj, për ta kuptuar me drejtë nëse shkaku i rishikimit me motivin se i pandehuri është gjykuar në mugesë, është shkak rishikimi apo shkak rigjykimi, Gjykata çmon të trajtojë në rastin konkret nëse me pranimin e kërkesës për rishikim me motivin se i pandehuri është gjykuar në mungesë, ai rivendoset në të gjitha të drejtat që ai do të kishte përfituar nëse gjykimi nuk do të ishte zhvilluar në mungesë të tij apo do të ketë të drejta të kufizuara, duke iu mohuar edhe e drejta për të përfituar gjykimin e shkurtuar, të cilin ai do ta kishte kërkuar nëse do të ishte njoftuar personalisht për procesin si dhe e drejta për të paraqitur prova të tjera e për të kërkuar nga Gjykata të dëgjohet përsëri si përsa i përket të drejtës ashtu edhe fakteve. Përpara se të bëjë interpretimin e dispozitave procedurale që rregullojnë insitutin e rishkimit të vendimeve gjyqësore, Gjykata çmon të evidentojë jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim GJEDNJ) lidhur me të drejtat që i cënohen të pandehurit në rastin e gjykimit në mungesë dhe se kush është mjeti procedural efektiv që do të garantonte rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur, pasi si Kushtetuta dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut është hartuar për të garantuar jo të drejta që janë teorike ose zhgënyese, por të drejta që janë praktike dhe efektive. Kështu, në vendimin Nr. 26, datë 08.05.2012 Gjykata Kushtetuese ndër të tjera ka

---

çdo rast edhe si mundësi gjykimi në atë shkallë të procesit në të cilën gjykimi nuk ka përfunduar në varësi të rastit dhe rregullimit që ka gjykimi në mungesë dhe e drejta e përfaqësimit. ***Me rishikim do të kuptojmë edhe ankimin ose rekursin si mjete të zakonshme e që mund të vihen në lëvizje nëpërmjet rivendosjes në afat, mjafton që qëllimi i kontrollit gjyqësor të vendimit të dhënë në mungesë dhe të drejtat e të gjykuarit të realizohen.".***

[4]Mundësia e rishikimit është parashikuar shprehimisht në nenin 4, paragrafi 2 të Protokollit nr.7 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, në të cilën thuhet se: "*..aktgjykimi i formës së prerë mund të rishqyrtohet edhe në rastet kur në procedurën e mëparshme* ***janë bërë shkelje esenciale****, të cilat kanë mundur të ndikojnë në zgjidhjen e çështjes penale...*".

Ishdijetaria.com

arsyetuar se: *"...Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se e drejta e palëve për të qenë të pranishme dhe për t'u mbrojtur në procesin gjyqësor, janë aspekte të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Referuar edhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), Gjykata ka përcaktuar ndër vite, disa standarde në lidhje me gjykimin në mungesë sipas të cilave: a) i pandehuri ka të drejtë të jetë i pranishëm në procesin gjyqësor të kryer në ngarkim të tij; b) i pandehuri mund të heqë dorë vullnetarisht nga ushtrimi i kësaj të drejtë; c) i pandehuri duhet të jetë në dijeni për ekzistencën e një procesi gjyqësor në ngarkim të tij; ç) duhet të ekzistojnë instrumente paraprake ose riparuese për të shmangur procese në ngarkim të të pandehurit, ose për të siguruar një proces të ri dhe, nëpërmjet depozitimit të provave të reja, të drejtën e mbrojtjes që nuk ka qenë e mundur të ushtrohet personalisht në procesin e zhvilluar në mungesë, të përfunduar tashmë (shih vendimet nr.30, datë 17.06.2010, nr.45, datë, më 10.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese). Sipas praktikës së kësaj Gjykate si dhe të GJEDNJ-së, është detyrë e autoriteteve shtetërore përkatëse që të njoftojnë në mënyrë rigoroze, konform kërkesave procedurale, të pandehurin ndaj të cilit ka filluar një proces penal, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet në përfundimin se i pandehuri ka hequr dorë me vullnetin e tij të lirë nga pjesëmarrja në gjykim. Vërtetimi i këtyre fakteve, sipas Gjykatës, është detyrë e organeve kompetente. Me këtë detyrim të organeve përkatëse shtetërore, për të njoftuar në mënyrë rigoroze të pandehurin dhe për të provuar se ai i fshihet drejtësisë, është e lidhur e drejta e tij për të marrë pjesë në gjykim, si dhe e drejta e gjykatës për të vendosur për gjykimin e tij në mungesë, kur janë respektuar në mënyrë rigoroze dispozitat për njoftimin (shih vendimet nr.30, datë 17.06.2010, nr.45, datë, më 10.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese).* ***Si konkluzion, sipas jurisprudencës së kësaj Gjykate, në radhë të parë është e domosdoshme që i pandehuri duhet të ketë dijeni në se ndaj tij ka filluar një proces penal dhe, në radhë të dytë, ky duhet të heqë dorë vullnetarisht nga pjesëmarrja në të. Gjykata ka arritur në këtë përfundim, për arsye se heqja dorë nënkupton një akt vullneti nga ana e të pandehurit, që siç është pranuar nga teoria e së drejtës penale, për të pasur një akt vullnetar, duhet të ketë në radhë të parë një proces të brendshëm të perceptimit të realitetit nga ana e të pandehurit dhe më pas një proces të brendshëm vendimmarrjeje prej tij*** *((shih vendimet nr.30, datë 17.06.2010; nr.45, datë 10.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese). Veç sa me sipër, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës ka miratuar Rezolutën (75) 11 "Për kriteret e gjykimit në mungesë të të akuzuarit", duke u rekomanduar shteteve anëtare që të mbajnë parasysh 9 rregulla minimale: (i) askush nuk duhet të gjykohet pa pasur një thirrje për gjyq në kohë; (ii) kjo thirrje për gjyq duhet të ketë të sanksionuara edhe pasojat nëse i akuzuari nuk vjen në gjykim; (iii) kur gjykata vëren se edhe pse i akuzuari është njoftuar dhe nuk është paraqitur, ajo, nëse çmon se prania e tij në proces është e pazëvendësueshme ose beson se i akuzuari është penguar të paraqitet, duhet të vendosë shtyrjen e procesit; (iv) i akuzuari nuk duhet të gjykohet në mungesë, nëse është e mundur të transferohen procedimet te një shtet tjetër ose të aplikohet për ekstradim; (v) kur i akuzuari gjykohet në mungesë, provat duhet të merren në mënyrë të zakonshme dhe mbrojtja duhet të ketë të drejtë të ndërhyjë; (vi) një vendim gjykate, i dhënë në mungesë, duhet t'i njoftohet personit sipas rregullave për njoftimet dhe marrjes dijeni brenda afatit të parashikuar për apelim. Ky afat duhet të fillojë që nga dita e marrjes dijeni efektivisht të personit, përveçse kur ai qëllimisht i fshihet drejtësisë;*

Ishqiptarja.com

(vii) çdo personi të gjykuar në mungesë, duhet t'i jepet e drejta për apelim, me çdo lloj mjeti ligjor që do t'i ishte dhënë sikur ai të ishte i pranishëm; (viii) për personin e gjykuar në mungesë, të cilit nuk i është bërë njoftimi në mënyrën e duhur, duhet të ketë një mjet ankimi që t'i mundësojë atij shfuqizimin e vendimit; (ix) një person i gjykuar në mungesë, por që njoftimi i është bërë në rregull, duhet të ketë të drejtën e një rigjykimi në mënyrën e zakonshme, nëse ai mund të provojë mungesën e tij para gjykatës për arsye të pavarura nga vullneti i tij. ***Duke u bazuar në këto parime, edhe GJEDNJ-ja ka përcaktuar kritere të qarta dhe të plota për drejtësinë kushtetuese lidhur me gjykimin në mungesë. Ajo ka theksuar se e drejta e një personi të akuzuar, për të qenë i pranishëm në seancën dëgjimore të akuzave të ngritura kundër tij, është thelbësore për një proces të drejtë (Ektabani kundër Suedisë, 1988; Vaundelle kundër Francës, 2003). Kjo përfshin jo vetëm praninë fizike, por edhe aftësinë për të dëgjuar dhe ndjekur procedimet, për të kuptuar provat dhe argumentet, për të orientuar përfaqësuesit ligjorë dhe për të dhënë fakte.*** *Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur procedimet kanë natyrë kontradiktore. Shteti ka detyrimin për t'i dhënë të pandehurit një njoftim efektiv dhe të përshtatshëm për seancën dhe të marrë masa për të siguruar praninë e tij (Poitrimol kundër Francës, 1993; Spinatto kundër HMP Brixton dhe Italisë, 2001). Gjykata thekson se është e një rëndësie thelbësore, që i akuzuari të jetë i pranishëm në seancë, sepse ai ka të drejtën të dëgjohet, por edhe sepse ai ka nevojë t'i verifikojë gjykatës vërtetësinë e thënieve të tij dhe t'i krahasojë këto me të palës tjetër ose dhe të dëshmitarëve. Ligjvënësi duhet të jetë në gjendje të mos nxisë mungesa të pajustifikueshme (Geyseghem kundër Belgjikës, 1999). Edhe pse nuk është absolute, e drejta e çdokujt, të akuzuar për një vepër penale, për t'u mbrojtur efektivisht nga një mbrojtës ligjor, është një nga kriteret kryesore të gjykimit të drejtë. Një person i akuzuar penalisht nuk e humb këtë të drejtë thjesht për faktin se ai nuk ndodhet vetë personalisht në gjyq (Mariani kundër Francës, 2005). GJEDNJ-ja është shprehur gjithashtu se të informosh dikë për një proces të hapur kundër tij, është një akt gjyqësor i një rëndësie të veçantë që duhet bërë në përputhje me kërkesat procedurale dhe thelbësore, të cilat garantojnë ushtrimin efektiv të të drejtave nga ana e të pandehurit. Njoftimi i paqartë dhe joformal nuk mjafton.* ***<u>Ndërkohë, nëse mund të pranohet një njoftim edhe tërthorazi, heqja dorë duhet të jetë e qartë. Është një e drejtë e personit të dënuar in absentia, i cili nuk rezulton se ka hequr dorë në mënyrë të qartë nga e drejta e tij për t'u paraqitur në gjykim, të ketë në të gjitha rastet një vendim të ri mbi akuzat</u>*** *(Sejdovic kundër Italisë, 2000). KEDNJ-ja u lë shteteve kontraktuese një diskrecion të gjerë lidhur me zgjedhjet e mjeteve, për të siguruar se sistemi i tyre ligjor është në përputhje me kërkesat e nenit 6 të saj. Detyra e GJEDNJ-së është të shqyrtojë nëse rezultati që KEDNJ-ja kërkon, është arritur nga shtetet kontraktuese.* ***Veçanërisht, mjetet procedurale të ofruara nga legjislacioni i brendshëm dhe praktika duhet të tregojnë se ato kanë qenë efektive, kur një person i akuzuar penalisht nuk ka hequr dorë nga të drejtat e tij për t'u dëgjuar dhe mbrojtur personalisht dhe as nuk i është fshehur drejtësisë (shih vendimet nr.30, datë 17.06.2010; nr.45, datë 10.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese).*** *Gjithsesi, jo vetëm shkronja, por as dhe fryma e nenit 6 të KEDNJ-së nuk e ndalojnë një person të heqë dorë nga të drejtat e tij, me dëshirë shprehimisht ose faktikisht. Por, megjithatë,* ***për qëllimet e KEDNJ-së do konsiderohet efektive, që të drejtat e atij, që ka hequr dorë prej tyre, të sanksionohen pa ekuivoke dhe të shoqërohen me një minimum të garancive, për shkak të rëndësisë së tyre. Autoritetet kombëtare***

Ishqiptarja.com

kanë një marzh vlerësimi për zgjedhjen e mjeteve në sistemet e tyre ligjore, por me kusht që këto mjete juridike të jenë në përputhje me standardet e vendosura nga neni 6/1 i KEDNJ-së *(Colozza kundër Italisë, 1985). Në këtë drejtim, GJEDNJ-ja është shprehur se " ... njoftimi i të akuzuarit në lidhje me akuzat në ngarkim të tij përbën një akt të një rëndësie të tillë, ku duhet të ekzistojnë elemente të formës dhe përmbajtjes që të garantojnë ushtrimin efektiv të të drejtave të mbrojtjes nga i akuzuari ... për rrjedhojë një njohuri e pasaktë dhe e marrë nga burime jozyrtare nuk është e mjaftueshme" (Somogyi kundër Italisë, 18.05.2004)...".*

7.2.1. **Në çështjen *Shkalla kundër Shqipërisë* "Ankimi Nr. 26866/05" GJEDNJ-ja me vendimin e datës 10 Maj 2011** ka gjetur shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi shtetasi A.Sh është gjykuar në mungesë, pa u njoftuar personalisht për gjykimin e zhvilluar në ngarkim të tij. Në arsyetimin e këtij vendimi ndër të tjera theksohet se: *"3. Në çështjen në fjalë, Gjykata konstatoi se ishte shkelur rëndë nga autoritetet vendase e drejta e ankuesve për një gjykim të drejtë.* ***Gjykata vëren se kur një ankues është dënuar për shkelje të të drejtave të tij të garantuara në nenin 6 të Konventës, ai duhet, sa të jetë e mundur, të vendoset në pozicionin në të cilin ai do të kishte qenë nëse kushtet e asaj dispozite nuk do të shkeleshin, dhe që në parim, forma më e duhur shqyrtimit, do të gjykohej de novo apo rihapja e procedimeve, nëse kërkohej*** *(shih Caka k. Shqipërisë, nr. 44023/02, § 122, 8 dhjetor 2009; Salduz, cituar më lart, § 72; Xheraj k. Shqipërisë, nr.37959/02, § 82, 29 korrik 2008; Öcalan k. Turqisë [GC], nr. 46221/99, § 210 in fine, GJEDNJ 2005-IV). 4. Gjykata konsideron se, në çështjen në fjalë, një rigjykim ose rihapje e çështjes, nëse kërkohet nga ankuesi, në parim përfaqëson mënyrën e duhur të rregullimit të shkeljes. Kjo është në përputhje me udhëzimet e Komitetit të Ministrave, që në rekomandimin nr. R (2000) 2 i kërkonte Shteteve anëtare të Konventës futjen e mekanizmave për rishqyrtimin e çështjes dhe rihapjen e procedurave gjyqësore në nivelin vendas, duke konstatuar që masa të tilla përfaqësonin "mjetin më efikas, nëse jo të vetmin për arritjen e dëmshpërblimit in integrum" (shih paragrafin më lart). 5. Gjykata vëren se sistemi ligjor penal i Shtetit të paditur nuk parashikon mundësinë e rishqyrtimit të çështjeve, duke përfshirë rihapjen e procedurave vendase, në rast se kjo Gjykatë konstaton shkelje të rëndë të së drejtës së ankuesit për gjykim të drejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës të tregojë se si mund të sigurohet një mundësi e tillë dhe çfarë forme duhet të marrë ajo.* ***Shteti i paditur mbetet i lirë, nën monitorimin e Komitetit të Ministrave, për të zgjedhur mjetet me të cilat do të kryejë detyrimin e tij për të vendosur ankuesin, sa është e mundur, në pozicionin që ai do të kishte qenë nëse kërkesat e Konventës nuk do të ishin shkelur (shih Piersack k. Belgjikës (neni 50), 26 tetor 1984, § 12, seria A nr.85), me kusht që mjete të tilla të jenë në përputhje me konkluzionet e përcaktuara në vendimin e Gjykatës, si dhe me të drejtat e mbrojtjes*** *(shih Lyons dhe të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar (dec.), nr.15227/03, GJEDNJ 2003-IX)."*.

7.2.2. Gjithashtu, **në çështjen *Izet Haxhia kundër Shqipërisë* "Ankimi Nr. 34783/06" GJEDNJ-ja me vendimin e datës 5 Nëntor 2013** ka gjetur shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi shtetasi Izet Haxhia është gjykuar në mungesë, pa u njoftuar personalisht për gjykimin e zhvilluar në ngarkim të tij. Në arsyetimin e këtij vendimi ndër të tjera theksohet se: *"82. Megjithëse procedimet e bëra në mungesë të pandehurit nuk janë në vetvete të papajtueshme me nenin 6 të Konventës, gjithsesi* ***mohimi i drejtësisë ndodh pa dyshim kur një person i dënuar***

Ishqiptarja.com

në mungesë nuk është në gjendje më pas të përfitojë nga gjykata, e cila ka dëgjuar përcaktimin e tij të ri të meritave të akuzës, <u>si për sa i përket së drejtës ashtu edhe fakteve</u>, kur nuk është përcaktuar se ai ka hequr dorë nga e drejta e tij për t'u paraqitur dhe për t'u mbrojtur vetë *(...) ose se ai synonte t'i shpëtonte gjykimit (...). 83. Konventa u lë shteteve kontraktuese diskrecion të gjerë në lidhje me zgjedhjen e mjetit të llogaritur për të garantuar se sistemet e tyre ligjore janë në përputhje me dispozitat e nenit 6. Detyra e Gjykatës është të përcaktojë nëse është arritur rezultati i kërkuar sipas Konventës. Në veçanti, mjetet procedurale, të ofruara nga e drejta dhe praktika e brendshme, duhet të tregojnë se janë efektive kur një person i akuzuar për një vepër penale nuk ka hequr dorë nga e drejta e tij për t'u paraqitur dhe për t'u mbrojtur vetë dhe as nuk ka kërkuar t'i shmanget gjykimit. 84. Gjykata më tej ka vendosur se detyra për të garantuar të drejtën e të pandehurit penal për të qenë i pranishëm në sallën e gjyqit... ose gjatë procedimeve të para ose në rigjykim – radhitet si një nga kërkesat themelore të nenit 6 (...).* ***Për rrjedhojë, refuzimi për të rifilluar procedimet e kryera në mungesë të të pandehurit, pa treguar se i pandehuri ka hequr dorë nga e drejta e tij për të qenë i pranishëm gjatë gjykimit, është konstatuar si "mohim flagrant i drejtësisë", duke bërë që procedimet të jenë "haptazi në kundërshtim me dispozitat e nenit 6 ose parimet e shprehura në të" (...)…..70. Gjykata përsërit konstatimet e saj në çështjen Shkalla k. Shqipërisë (nr. 26866/05, §§ 77-79, 10 maj 2011), se kur një ankues është dënuar në shkelje të të drejtave të tij të garantuara nga neni 6 i Konventës, <u>forma më e përshtatshme e ndreqjes do të ishte që sa të jetë e mundur ankuesi të vendoset në pozicionin që do të kishte qenë nëse kjo dispozitë do të respektohej.</u>*** *Forma më e përshtatshme e ndreqjes, në parim, do të ishte gjykimi de novo ose rifillimi i procedimeve nëse kërkohet (shih, gjithashtu, Xheraj k. Shqipërisë, nr. 37959/02, § 82, 29 korrik 2008; Caka k. Shqipërisë, nr. 44023/02, § 122, 8 dhjetor 2009, dhe Laska k. Shqipërisë, cituar më lart, §§ 73-77)."*. Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton se do të përbënte mohim të drejtësisë nëse një i pandehur i gjykuar në mungesë nuk do t'i garantohet e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur si përsa i përket faktit penal ashtu dhe të drejtës, ku hynë mënyra e zbatimit të ligjit material e procedural. Gjithashtu, në këtë vendim si dhe në vendime të tjera kundër Shqipërisë, GJEDNJ-ja thekson se forma më e përshtatshme e ndreqjes do të ishte që sa të jetë e mundur i pandehuri të vendoset në pozicionin që do të kishte qenë nëse do të ishte njoftuar personalisht për procesin e për rrjedhojë gjykimi nuk do të zhvillohej në mungesë të tij. Pra, në vendimet e saj, GJEDNJ-ja ka shprehur parimin e njohur të së drejtës ndërkombëtare *restitutio in integrum.*

7.2.3. Lidhur me fuqinë juridike të vendimeve të GJEDNJ-së në sistemin tonë juridik, Gjykata çmon t'i referohet jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, e cila në vendimin Nr. 20, datë 01.06.2011[5] ndër të tjera ka theksuar se: "*Gjykata, në vijim të argumenteve të saj, e sheh me vend të theksoje se,* ***për trajtimin e të drejtave themelore të njeriut, GJEDNJ-ja ka në sistemin tonë juridik një kompetencë ekskluzive. Kjo kompetencë është e pranuar nga sistemi ynë i brendshëm juridik, për efekt të zbatimit te nenit 122 të Kushtetutës, po edhe të nenit 17/2 të saj, të cilët sjellin***

[5] Në vendimin Nr. 5, datë 2 Shkurt 2001 të Gjykatës Kushtetuese ndër të tjera thuhet se: "***Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i tillë që iu imponon të gjithë organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, <u>fuqinë detyruese të arsyetimit të vendimit të saj</u>****. Arsyetimi që përdor Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale*".

Ishqiptarja.com

si detyrim që vendimet e GJEDNJ-së të zbatohen drejtpërsëdrejti. Me rastin e ratifikimit të KEDNJ-së Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, si përfaqësues i sovranitetit popullor, ka marrë përsipër detyrime të cilat janë të zbatueshme nga të gjitha organet shtetërore të Republikës së Shqipërisë, <u>përfshirë gjykatat e të gjitha niveleve, pavarësisht llojit të tyre</u>. Për sa më sipër, detyrimet që mbartin secili nga pushtetet për zbatimin e vendimeve përfundimtare të GJEDNJ-së janë të ndryshme. *Nëse për ekzekutivin janë menjëherë të ravijëzueshme këto detyrime, si p.sh. në rastin e pagimit të dëmshpërblimeve të imponuara nga GJEDNJ-ja, për sa i përket dy pushteteve të tjera ka vend për interpretim.* ***<u>Posaçërisht për sa i përket vendimeve të GJEDNJ-së për procedime penale, për legjislativin lind nevoja që të marrë masa për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm me dispozitat e KEDNJ-së. Nëse nuk ka harmonizim pra, nëse jemi në rastet e vakumit legjislativ, ose kur parashikimet ligjore bien në kundërshtim me dispozitat e Konventës, atëherë gjyqtarët e çdo niveli zbatojnë drejtpërsëdrejti vendimet e GJEDNJ-së në përputhje me nenin 122 të Kushtetutës dhe nenet 19 dhe 46 të KEDNJ-së. Neni 122 i Kushtetutës përcakton shprehimisht se dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare kane epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.”,</u>*** ndërsa në vendimin Nr. 45, datë 01.11.2013 Gjykata Kushtetuese lidhur me fuqinë juridike të GJEDNJ-së ndër të tjera ka theksuar se: *“10. Vendimet e GJEDNJ-së kanë vlerën e tyre në dy aspekte, që lidhen me natyrën detyruese, që rrjedh nga nenet 1 dhe 46 të Konventës, dhe me mënyrën e zbatimit të tyre në sistemin e brendshëm. GJEDNJ-ja ka sqaruar parimet që rregullojnë zbatimin e vendimeve të saj, duke i vënë theksin zbatimit efektiv të këtyre vendimeve (vendimi në çështjen Verein Gegen Tierfabriken Schëeiz (VgT) kundër Zvicrës (nr. 2), datë 30.06.2009). Sipas kërkesave të nenit 46 të KEDNJ-së, një shtet palë për të cilin GJEDNJ-ja është shprehur se ka shkelur Konventën ose Protokollet e saj, ka detyrimin që të veprojë në përputhje me vendimin e asaj Gjykate. Me fjalë të tjera, një dështim tërësor ose i pjesshëm i ekzekutimit të vendimit të GJEDNJ-së lind përgjegjësinë ndërkombëtare të shtetit. Shteti në fjalë ka detyrimin jo vetëm të shlyejë dëmin material ndaj personave të interesuar, por edhe të marrë masa individuale dhe/ose, nëse është e përshtatshme, masa të përgjithshme në rendin e vet ligjor, që t’i japë fund shkeljes së gjetur nga Gjykata dhe të rregullojë pasojat e shkeljes, me qëllimin që kërkuesi të rikthehet, për aq sa është e mundur, në gjendjen që ishte para se të bëhej shkelja (vendimi në çështjen Scozzari dhe Giunta kundër Italisë, nr. 39221/98 dhe 41963/98, § 249, ECHR 2000-VIII, dhe Assanidze kundër Gjeorgjisë, nr. 71503/01, § 198, ECHR 2004-II).* ***Në vendimet e saj GJEDNJ-ja ka shprehur parimin e njohur të së drejtës ndërkombëtare restitutio in integrum, i cili është përdorur shpesh nga Komiteti i Ministrave në rezolutat e tij.*** *Edhe pse në lidhje me mënyrën se si do të zbatojnë detyrimet e parashikuara në nenin 46 të Konventës për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së, shtetet palë të Konventës gëzojnë diskrecion dhe Konventa nuk përmban dispozita që t’u imponojë Palëve Kontraktuese detyrimin për të parashikuar në ligjin e brendshëm rishqyrtimin apo rihapjen e procedimeve, ekzistenca e mundësive të tilla, në rrethana të veçanta, ka provuar të jetë e rëndësishme dhe, në disa raste, i vetmi mjet për të arritur restitutio in integrum.”*[6]. Ndodhur në këto kushte, Gjykata vlerëson se standarti i vendosur nga GJEDNJ-ja, ku theksohet se do të përbënte mohim të drejtësisë nëse një i pandehur i gjykuar në mungesë nuk do t’i garantohet e drejta për t’u dëgjuar e për t’u mbrojtur si përsa i përket faktit penal ashtu dhe të

[6] Memorandumi shpjegues i Rekomandimit R (2000) 2, https://ëcd.coe.int/VieëDoc.jsp?id=334147&Site=CM.

Ishqiptaria.com

drejtës, dhe se forma më e përshtatshme e ndreqjes do të ishte që sa të jetë e mundur ankuesi/i pandehuri të vendoset në pozicionin që do të kishte qenë nëse do të ishte njoftuar personalisht për procesin, e për rrjedhojë gjykimi nuk do të zhvillohej në mungesë të tij, është i detyrueshëm të mbahet parasysh nga gjykatat e sistemit të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë.

7.3. Gjykata çmon të trajtoj kufijtë e shqyrtimit nga gjykata e rishikimit duke iu referuar secilit prej rasteve të rishikimit, për të konkluduar nëse kufijt e shqyrtimit janë të njëjta për të gjitha rastet e rishikimit. Kështu, në nenin 453 të K.Pr.Penale nën titullin "**Shqyrtimi i kërkesës"** parashikohet shprehimisht se: *"1. Kërkesa e rishikimit shqyrtohet nga gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve. 2. Kur kërkesa është bërë jashtë rasteve të përcaktuara në nenin 450 ose kur është bërë nga ata që nuk e kanë këtë të drejtë ose kur rezulton haptazi e pambështetur, gjykata vendos mospranimin e saj. 3.* ***Kur kërkesa pranohet, gjykata vendos dërgimin e çështjes për rigjykim nga një tjetër trup gjykues i së njëjtës gjykatë ose në gjykatën e apelit, kur kërkesa është bërë vetëm kundër vendimit të saj. Kundër vendimit nuk lejohet ankim*** *4. Deri në dhënien e vendimit nga gjykata e rishikimit, sipas nenit 456, të këtij Kodi, i dënuari ruan të njëjtën pozitë procedurale.",* ndërsa në nenin 455 të këtij Kodi nën titullin "**Gjykimi i rishikimit"** parashikohet shprehimisht se: *"1. Gjykata, e caktuar për rigjykimin e çështjes, cakton datën e seancës gjyqësore dhe urdhëron thirrjen e palëve.* ***2. Respektohen dispozitat e gjykimit të shkallës së parë brenda kufijve të shkaqeve të parashtruara në kërkesën e rishikimit****."*. Gjithashtu, në nenin 456 të K.Pr.Penale nën titullin **"Vendimi"** parashikohet shprehimisht se: *"1. Vendimi merret sipas dispozitave për marrjen e vendimit nga gjykata e shkallës së parë.* ***2. Kur pranohet kërkesa e rishikimit, gjykata prish vendimin. Nuk mund të jepet vendim vetëm duke bërë një vlerësim tjetër të provave të marra në gjykimin e mëparshëm.*** *3. Kur rrëzohet kërkesa, gjykata detyron atë që e ka bërë me shpenzimet procedurale dhe kur është urdhëruar pezullimi, vendos rivënien në ekzekutim të dënimit* ***ose të masës së sigurimit****. 4. Me kërkesën e të interesuarit, vendimi i pafajësisë afishohet i shkurtuar në rrethin ku është dhënë vendimi dhe në vendbanimin e fundit të të dënuarit. Kryetari i gjykatës mund të urdhërojë që ky vendim të shpallet në një gazetë të caktuar."*. Nga interpretimi logjik e sistematik të këtyre dispozitave me rastet e rishikimit, Gjykata arrinë në këto përfundime:

7.4**. Së pari**, rishikimi është mjet ankimi i jashtëzakonshëm dhe përjashtimor kundër një vendimi gjyqësor penal të formës së prerë, i cili nuk mund të kundërshtohet nëpërmjet mjeteve të zakonshme të ankimit (apeli dhe rekursi). Në këto kushte, kur janë shterur mjetet e zakonshme të ankimit, vendimi është i formës së prerë dhe çështja konsiderohet e mbyllur në bazë të parimit të gjësë së gjykuar *(res judicata).* Në nenin 449 të K.Pr.Penale[7] përcaktohet se cilët vendime mund të jenë objekt rishikimi. Rishikimi si mjet i jashtëzakonshëm ankimi, sipas nenit 451 të K.Pr.Penale, pas ndryshimeve të bëra me Ligjin Nr. 35/2017 mund të jetë vetë ***extra ordinem pro reo*** dhe jo ***contra reum,*** pasi nuk lejohet rishikimi i vendimit të pafajësisë dhe vendimi i dënimit kur synohet rëndimi i pozitës së të dënuarit. Në rastin *pro reo* rishikimi bëhet me kërkesë të të

[7] Në nenin 449 të K.Pr.Penale nën titullin **"Vendimet që mund të rishikohen"** parashikohet shprehimisht se: *"1. Në rastet e caktuara me ligj lejohet në çdo kohë rishikimi i vendimeve që kanë marrë formën e prerë, edhe kur dënimi është ekzekutuar ose është shuar. 2. Nuk lejohet rishikimi i vendimit të pafajësisë dhe as rishikimi i vendimit të dënimit kur synohet rëndimi i pozitës së të dënuarit."*.

[shqiptaria.com]

dënuarit me qëllimin për të provokuar një rivlerësim të së vërtetës në drejtimin e kundërshtimit të vendimit të fajësisë dhe të mundësisë që rihapja e procesit sjell potencialisht mundësinë e dhënies së një vendimi pafajësie. Në themel të rishikimit qëndron parimi se drejtësia duhet të jetë e vërtetë duke thyer kornizat procedurale të mbylljes përfundimtare të gjykimit. Gjykimi rishikues, mbasi i hapet rrugë kërkesës së rishikimit nga gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve, zhvillohet në gjykatën e shkallës së parë që ka dhënë vendimin ose në gjykatën e apelit kur kërkesa bëhet vetëm kundër këtij vendimi (neni 453/3 i K.Pr.Penale). **Shqyrtimi i ri gjyqësor rishikues si rregull zhvillohet në gjykatën e shkallës së parë në një gjykim publik. Rregullat procedurale që ndiqen janë ato të parashikuara në kapitullin e gjykimit të shkallës së parë, duke mbajtur parasysh veçoritë e gjykimit rishikues. Rishikimi i vendimit, duke qenë mjet i jashtëzakonshëm ankimi i një vendimi të formës së prerë, nuk pas sjell pavlefshmërinë e provave të marra dhe të përdorura në vendimin që do të rishikohet. Veçoria e këtij gjykimi qëndron në marrjen e atyre provave të cilat kanë shërbyer si shkak për pranimin e rishikimit. Gjykata që rishikon çështjen është e detyruar të marrë në rivlerësim provat të cilat kanë shërbyer në dhënien e vendimit pa ju futur edhe një herë shqyrtimit të tyre dhe duke e përqendruar hetimin gjyqësor vetëm në ato prova të cilat kanë shërbyer si objekt i kërkesës për rishikim e që janë përdorur si shkak për pranimin e rishikimit. Në këtë proces rishikues vlerësimi i provave të reja do të jetë në tërësi së bashku me provat e tjera të shqyrtuara më parë me qëllimin që provat e reja së bashku ose në mënyrë të veçantë të çojnë gjykatën në konfirmimin e vendimit të parë që rishikohet, ose në një vendimmarrje të ndryshme.** Në rastin kur vendimi i rishikuar prishet atëherë vendimi i ri i pafajësisë në rast se kërkesa e rishikimit bëhet nga i dënuari pas sjell efektet juridike të cilat çojnë edhe në ndryshimin e statusit të të gjykuarit në atë të pandehurit, duke e futur procesin në *iter* të zakonshëm duke i dhënë të drejtën e ankimit dhe të kontrollit gjyqësor nëpërmjet mjeteve të zakonshme të ankimit. Në rast se kërkesa për rishikim rrëzohet dhe konfirmohet dënimi për të gjykuarin dhe është disponuar pezullimi i ekzekutimit, atëherë ky vendim i humbet fuqitë dhe do të procedohet me vazhdimin e vuajtjes së dënimit me burgim. ***(shiko vendimin unifikues Nr. 3, datë 08.07.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë***).[8] **Gjykata vlerëson se këto rregulla lidhen vetëm me shkaqet e rishikimit të parashikuara nga neni 450 pika 1 gërmat "a", "b", "c" dhe "ç" kur rishikimi ka për qëllim rishikimin e çështjes së përfunduar me vendime të formës së prerë, për shkak se vendimi i gjykatës është i gabuar përsa i përket çmuarjes së faktit**. Pra, në këto raste nuk kemi një rifillim të procesit nga e para, por gjykata e rishikimit bën një çelje të pjesshme të hetimit gjyqësor dhe merrë provën që ka dalë rishtazi. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e rishikimit për shkaqet e rishikimit të parashikuara nga neni 450 pika 1 gërmat "a", "b", "c" dhe "ç" ka dy vendimarrje ose të lërë në fuqi dënimin e caktuar ose të prishë vendimin e ta deklarojë të pandehurin të pafajshëm.

7.5. **Së dyti,** Gjykata lidhur me shkaqet e rishikimit të parashikuara nga neni 450 pika 1 gërmat "d", "dh", dhe "e", çmon se nuk mund të janë të zbatueshme rregullimet e parashikuara

[8] Ky qëndrim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë është mbajtur në situatën juridike, kur nuk ishin bërë ndryshimet me Ligjin Nr. 35/2017, ku janë shtuar tre shkaqe të reja rishikimi të parashikuara nga neni 450 pika 1 gërmat "d", "dh", dhe "e".

[shqiptaria.com]

nga neni 453 pika 4 dhe 456 pika 2 të K.Pr.Penale. Kjo për faktin pasi këto shkaqe lidhen në thelb me cënimin e së drejtës së të pandehurit për një proces të rregullt ligjor, të cilat e bëjnë nul të gjithë procesin gjyqësor që është zhvilluar në mungesë të të pandehurit. Kështu në nenin 128 të K.Pr.Penale nën titullin **"Pavlefshmëria absolute"** parashikohet shprehimisht se: *"1. Aktet procedurale janë absolutisht të pavlefshme kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me: ....c)* ***thirrjen e të pandehurit****, viktimës ose praninë e mbrojtësit* ***kur ajo është e detyrueshme****. 2. Një akt i cilësuar me ligj si absolutisht i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm."*. Gjykata çmon se thirrja e të pandehurit për të marrë pjesë në procesin që zhvillohet kundër tij është materializim i të drejtës së tij për t'u vetëmbrojtur, sikurse sanksionohet në nenin 31[9] dhe 33 pika 1[10] të Kushtetutës. Pra, thirrja e të pandehurit dhe tashmë pas ndryshimeve që janë bërë me Ligjin Nr. 35/2017 edhe të viktimës[11] nga organi procedues duhet realizohen nëpërmjet formave të njoftimit që parashikohen nga nenet 132, 134, 137, 138 139, 140, 140/a, 141 dhe 142 të K.Pr.Penale. Mosnjoftimi i të pandehurit[12] sipas jurisprudencën së Gjykatës Kushtetuese passjellë shkeljen e disa të drejtave, duke e bërë gjithë procesin absolutivisht të pavlefshëm, e për rrjedhojë çështja duhet rigjykuar nga e para. **Sikurse u theksua më lart, shkaqet e rishikimit të parashikuara nga neni 450 pika 1 gërmat "d", "dh", dhe "e", nuk janë shkaqe rishikimi të mirëfillta që i përshtaten rishikimit si mjet i jashtëzakonshëm ankimi, por janë raste të mirëfillta të rigjykimit pas prishjes së vendimit për shkeljen e të drejtë për një proces të rregullt ligjor.** Kështu, në nenin 428 pika 1 gërma "ç" nën titullin "**Vendimi i gjykatës së apelit"** parashikohet shprehimisht se: ***"****1. Gjykata e apelit, pasi shqyrton çështjen, vendos:...****ç) prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve gjykatës së shkallës së parë kur nuk janë respektuar dispozitat që lidhen****,....* ***me pjesëmarrjen e të pandehurit, të mbrojtësit të tij.....****2. Një kopje e vendimit i njoftohet menjëherë gjykatës së shkallës së parë."*, ndërsa në nenin 432 pika 1 gërma "b" të këtij Kodi nën titullin "**Rekursi kundër vendimeve të gjykatës së apelit"** parashikohet shprehimisht se: *"1. Rekursi në Gjykatën e Lartë kundër vendimeve të gjykatës së apelit mund të bëhet për këto shkaqe: ....b) për mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit,* ***pavlefshmërinë absolute të akteve*** *ose* ***papërdorshmërinë e provave****;..."*. Nga përmbajtja e këtyre

---

[9] Në nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë thuhet se: "***Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë:*** *a) të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, si dhe t'i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij;* ***b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;*** *c) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe****; ç) të mbrohet vetë*** *ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme; d) t'u bëjë pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet."*.

[10] Në nenin 33 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë thuhet shprehimisht se: *"1. Kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet."*.

[11] Për viktimën K.Pr.Penale parashikon se njoftimi do të realizohet në format e parashikuara nga nenet 137 dhe 138 të K.Pr.Penale.

[12] Kështu në vendimin Nr. 9, datë 22.02.2001 kjo gjykatë shprehet se: *"Duke mos u njoftuar kërkuesi për ankimin e prokurorit si dhe për datën e gjykimit në Apel e në gjykatën e rrethit, atij i janë mohuar njëkohësisht disa të drejta kushtetuese të parashikuara edhe në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, siç janë e drejta për ta vënë në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet (neni 31/a i Kushtetutës dhe neni 6/3a i Konventës), e drejta për t'u mbrojtur vetë e për t'u bërë pyetje dëshmitarëve të pranishëm apo e drejta për të kërkuar marrjen e provave të tjera (neni 31/b,c të Kushtetutës dhe neni 6/3c,d i Konventës), si edhe e drejta për t'u dëgjuar para se të gjykohet (neni 33 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i Konventës)."*.

lsh.gjyqesia.com

dispozitave rezulton se gjykimi në mungesë i të pandehurit pa e njoftuar personalisht, bënë që të gjitha aktet procedurale të kryera gjatë gjykimit, përfshi këtu dhe vendimin përfundimtar janë absolutivisht të pavlefshëm, për rrjedhojë përbën shkak për prishjen dhe rigjykimin nga e para të të pandehurit. **Ndodhur në këto kushte, Gjykata vlerëson se në rast se pranohet kërkesa për rishikimin e vendimit për një nga shkaqet e parashikuara nga neni 450 pika 1 gërmat "d", "dh", dhe "e" dhe e dërgon çështjen për rigjykim, bën që vendimi për të cilin kërkohet rigjykimit i dhënë në mungesë të të pandehurit, të prishet automatikisht e për rrjedhojë i dënuari tashmë rimerr statusin e të pandehurit, pasi në vetvete është pranuar se të pandehurit i është cënuar e drejta për një proces të rregullt ligjor. Pra, Gjykata çmon se prishja e vendimit të dhënë në mungesë nuk bëhet në përfundimit të gjykimit të rigjykimit, por që në momentin e pranimit të kërkesës për rishikim sikurse veprohet në rastet e parashikuara nga nenet 428 pika 1 gërma "ç" dhe 432 pika 1 gërma "b" të K.Pr.Penale. Vendimi për pranimin e kërkesës për rishkimin është i paankimueshëm, për rrjedhojë për gjykatën e rishikimit fakti i gjykimit në mungesë të të pandehurit dhe mohimi i së drejtës së mbrojtjes si element të një procesit të rregullt ligjor, nuk mund të vihet më në diskutim. Prandaj, e vetmja detyrë e gjykatës së rigjykimit është t'a rivendosë të pandehurin në pozicionin në të cilin ai do të kishte qenë nëse do të ishte njoftuar rregullisht për procesin në ngarkim të tij, sikurse theksohet në jurisprudencën e GJEDNJ-së, ku gjyqtarët e çdo niveli janë të detyruar t'i zbatojnë drejtpërsëdrejti vendimet e saj në përputhje me nenin 122 të Kushtetutës dhe nenet 19 dhe 46 të KEDNJ-së. Pra, në këto raste, Gjykata do ti garantojë të pandehurit, të gjitha të drejtat që i gëzon sipas akteve ligjore që janë pjesë e rendit juridik të Republikës së Shqipërisë, pa i kufizuar asnjë të drejtë, duke përfshirë këtu edhe të drejtën për të kërkuar të procedohet me rregullat e gjykimit të shkurtuar.**

7.5.1. Gjykata çmon se çdo lloj interpretimi i ndryshëm nga sa citohet në paragrafin e mësipërm, duke mos e rivendosur të pandehurin në pozicionin në të cilin ai do të kishte qenë nëse do të ishte njoftuar rregullisht për procesin në ngarkim të tij, sikurse theksohet në jurisprudencën e GJEDNJ-së, për një nga shkaqet e parashikuara nga neni 450 pika 1 gërmat "d", "dh", dhe "e", do të bënte që neni 453 pika 4 dhe 456 pika 2 të K.Pr.Penale, të binte në kundërshtim me nenet 31, 33 dhe 42 Kushtetutën dhe nenin 6 dhe 13[13] të KEDNJ-në, që bën fjalë për respektimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe të drejtën për të pasur një mjet efektiv ankimi, i cili do të garantonte rivendosjes në vend të së drejtës së shkelur. Gjithashtu, nëse të pandehurit të gjykuar në mungesë pa e njoftuar rregullisht për procesin në ngarkim të tij nuk i garantohen të gjitha të drejtat në gjykimin e rishikimit atëherë do të sillte situata absurde, ku do ta disfavorizonte në raport me një të pandehur që e kanë njoftuar rregullisht për procesin në ngarkim të tij, në kundërshtim

[13] Shiko vendimin Nr. 64, datë 16.10.2017 të Gjykatës Kushtetuese, ku ndër të tjera thuhet se: *"Gjykata, referuar dhe jurisprudencës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), lidhur me interpretimin e nenit 13 të KEDNJ-së, ku sqarohet përmbajtja e termit "ankim efektiv", ka theksuar se është e rëndësishme të përcaktohet se çfarë mjetesh, sipas rastit, janë në dispozicion të individit dhe nëse ato i krijojnë atij mundësi reale për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në mënyrë efektive. Në këtë drejtim është evidentuar se një ndër kriteret që duhet të plotësojë një ankim për të qenë efektiv është që mjeti të ofrojë mundësi të qarta dhe të sigurta për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur. Ajo ka përcaktuar, gjithashtu, se mjeti që të jetë efektiv, duhet të jetë i përshtatshëm, i disponueshëm dhe efikas për një çështje konkrete (shih vendimet nr. 9, datë 15.03.2013; nr.27, datë 20.06.2007; nr.6, datë 31.03.2006 të Gjykatës Kushtetuese)."*.

Shqiptaria.com

me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës, kur në fakt procesi në mungesë është zhvilluar për shkak se autoritetet shtetërore kanë dështuar në misionin e tyre për t'a njoftuar rregullisht të pandehurin. Prandaj, në rastin konkret, Gjykata mban parasysh dhe vendimin Nr. 4, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese, ku ndër të tjera thuhet se: ***"...në zbatim të parimit të kushtetutshmërisë, përpara se t`i drejtohet Gjykatës duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar ligjin e zbatueshëm në përputhje me Kushtetutën*** *(shih vendimin nr.55, datë 21.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese).* ***Është detyrim i gjykatës referuese të zgjidhë dyshimet interpretative, duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet kushtetuese. Në këto kushte, gjyqtari referues është i detyruar të zbatojë, midis interpretimeve të ndryshme të mundshme, atë që konsiderohet se përputhet me parimin kushtetues, që në të kundërt do të cenohej.*** *Vetëm në rast se gjyqtari vlerëson se të gjitha interpretimet e mundshme bien në kundërshtim me Kushtetutën, atëherë ai duhet t`i drejtohet Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së normës të individualizuar si e zbatueshme në rastin konkret (shih vendimin nr.7, datë 16.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese).".* **Pra, Gjykata çmon se i vetmi interpretim pajtues me kushtetutën është ai bërë në paragrafin 7.5 të këtij vendimi. Për një nga shkaqet e parashikuara nga neni 450 pika 1 gërmat "d", "dh", dhe "e", rishikimi është pranuar si mjet ankimi i jashtëzakonshëm dhe përjashtimor kundër një vendimi gjyqësor penal të formës së prerë, i cili nuk mund të kundërshtohet nëpërmjet mjeteve të zakonshme të ankimit (apeli dhe rekursi), por pasi pranohet kërkesa për rishikim atëherë do të jemi përpara një rigjykimi të mirëfilltë sikurse parashikohet nga nenet 428 pika 1 gërma "ç" dhe 432 pika 1 gërma "b" të K.Pr.Penale, që passjellë fillimin e procesit gjyqësor nga e para duke i anuluar të gjitha aktet procedurale. Në këtë përfundim arrijë gjykata duke mbajtur parasysh parimin e së drejtës që *"kur motivet janë të njëjta edhe zgjidhja duhet të jetë e njëjtë".*** Në të kundërt, Gjykata vlerëson se nëse motivi i rishikimit do të lidhej me një vendim të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut që e bën të domosdoshëm rigjykimin e çështjes, që ka konstatuar shkelje të nenit 7 të KEDNJ-së, sikurse është rasti në çështjen *Scoppola kundër Italisë* "Ankimi Nr. 10249/03" vendimi i Dhomës së Madhe i datës 17 Shtator 2009,[14] dhe gjykata do të kishte vetëm dy kompetenca ose të rrëzonte kërkesën nëse nuk

[14] **Në çështjen *Scoppola kundër Italisë* "Ankimi Nr. 10249/03" vendimi i Dhomës së Madhe i datës 17 Shtator 2009**, të GJEDNJ-së ndër të tjera thuhet se: "*110. ...Gjykata duhet të përcaktojë nëse teksti i cili, në rastin në fjalë, i është nështruar ndryshimeve legjislative të parashtruara, përkatësisht Nenit 442 paragrafi 2 të KPP, përmban dispozita të së drejtës materiale, dhe në veçanti dispozitat që ndikojnë në kohëzgjatjen e dënimit të dhënë. 111. Gjykata vëren se neni 442 është pjesë e Kodit të Procedurës Penale, dispozitat e të cilave zakonisht rregullojnë procedurën e ndjekjes dhe gjykimit të shkelësve. Megjithatë, klasifikimi në ligjin vendas të legjislacionit në fjalë nuk mund të jetë vendimtar.* ***Megjithatë është e vërtetë që nenet 438 dhe 441 deri 443 të KPP përshkruajnë qëllimin dhe fazat procedurale të procedurës përmbledhëse, paragrafi 2 i Nenit 442 është tërësisht i lidhur me kohëzgjatjen e dënimit që do të shqiptohet kur gjykimi është kryer në përputhje me atë proces të thjeshtuar. Në veçanti, në kohën kur kërkuesi kreu veprat penale, neni 442 paragrafi 2 parashikonte që, në rast të dënimit, ndëshkimi i caktuar nga gjykata do të zvogëlohej me një të tretën. Ligji nr. 479 i vitit 1999, i cili hyri në fuqi para seancës paraprake dëgjimore në rastin e kërkuesit, më pas specifikoi se burgimi i përjetshëm duhej të zëvendësohej me tridhjetë vjet burgim.*** *(shih paragrafin 29 më lart). 112.* ***Nuk ka dyshim se dënimet e përmendura në Nenin 442 paragrafi 2 të KPP ishin ato që duhej të shqiptohen pas dënimit për një vepër penale. (shih Ëelch, cituar më lartë, paragrafi 28) se ata ishin të kualifikuar si "penale" në ligjin vendas dhe se qëllimi i tyre ishte jo vetëm parandalues por edhe ndëshkues. Përveç kësaj, ata përbënin "dënimin" e shqiptuar për veprimet më të cilat akuzohej i pandehuri, dhe jo masat lidhur me "ekzekutimin" ose "zbatimin" e një dënimi (shih Kafkaris, cituar më lart, paragrafi 142). 113. Në***

ligjiperjashtimi.com

do të jepte pafajësi ose të vendosë pafajësi (procedura standarte e rishikimit e jo e rigjykimit), nuk do të bëhej i mundur asnjëherë që të zbatohej vendimi i GJEDNJ-së. Kjo për faktin, pasi GJEDNJ-ja mund të konstatojë se i pandehuri është fajtor, por nga gjykatat shqiptare të pandehurit i është mohuar e drejta për të përfituar nga ligji penal që është më i favorshëm për të pandehurin, sikurse mund të ishte rasti që një person që akuzohet për një vepër penale që dënohet me burgim të përjetshëm për një fakt penal që ka ndodhur përpara hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 35/2017, i mohohet e drejta për të proceduar me gjykim të shkurtuar, me motivacionin se edhe pse në kohën kur është kryer vepra penale lejohej gjykimi i shkurtuar për veprat që parashikon një dënim me burgim të përjetshëm, me hyrjen në fuqi të ndryshimeve më datën 1 Gusht 2017 nuk lejohet më gjykimi i shkurtuar për këto vepra penale sipas parimit *tempus regit actum*. GJEDNJ-ja e ka konsideruar shkelje këtë qëndrim në çështjen *Scoppola kundër Italisë* "Ankimi Nr. 10249/03" vendimi i Dhomës së Madhe i datës 17 Shtator 2009. Për rrjedhojë nëse GJEDNJ-ja do të kishte penalizuar Shqipërinë në një rast të ngjashëm, ateherë e vetmja mënyrë për të rivendosur të drejtën do të ishte që të rifillonte nga e para procesi gjyqësor, i dënuari të rimerte statusin e të pandehurit, të paraqeste në fazën e kërkesave paraprake sipas nenit 354 kërkesën për gjykim të shkurtuar, gjykata do të ishte e detyruar ta pranonte dhe në përfundim t'i ulte një të tretën e masës së dënimit. Pra, vendimi i GJEDNJ-së në një rast të tillë nuk do të mund të zbatohet asnjëherë nëse Gjykata do të kishte vetëm dy kompetenca ose rrëzimin e kërkesës kur nuk rezulton i pafajshëm i dënuari në përfundim të procesit të rishikimit ose deklarimin e pafajshëm të tij, procedura standarte e rishikimit si mjet i jashtëzakonshëm ankimi kundër një vendimi të formës së prerë.

7.5.2. Gjithashtu, Gjykata e çmon të nevojshme të theksojë se, në bazë të nenit 145 të Kushtetutës, gjyqtarët iu nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve, duke respektuar hierarkinë e burimeve të së drejtës, si detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe koherencës së sistemit normativ (neni 4 i Kushtetutës). Kjo gjë arsyetohet me faktin e thjeshtë se rendi juridik nuk përbëhet nga norma juridike të barasvlershme apo me të njëjtën fuqi juridike, përkundrazi ai është një sistem i shkallëzuar, ku normat e së drejtës renditen në bazë të fuqisë juridike që kanë.

---

dritën e sa më sipër, Gjykata konsideron se neni 442 paragrafi 2 i KPP është një dispozitë e së drejtës materiale lidhur me kohëzgjatjen e dënimit që duhet të shqiptohet në rast të dënimit pas gjykimit sipas procedurës përmbledhëse. Prandaj, ajo bie në kuadër të fjalisë së fundit të Nenit 7 paragrafi 1 të Konventës.*".* Gjithashtu, në këtë vendim, GJEDNJ-ja analizoi nëse ndaj kërkuesit Scoppola është aplikuar ligji penal favorizues, duke aplikuar dënimin më të butë, duke theksuar ndër të tjera se: *"119. Nga kjo rrjedh se kërkuesit i është shqiptuar një dënim më i rëndë ai ai i parashikuar nga ligji, i cili nga të gjitha ligjet në fuqi gjatë periudhës ndërmjet kryerjes së veprës penale dhe dhënies së aktgjykimit të formës së prerë, ishte më i favorshëm për të.* ***(e) Përfundim*** *120. Në dritën e sa më sipër, Gjykata konsideron që Shteti i paditur nuk e ka përmbushur detyrimin e tij për t'i dhënë kërkuesit përfitimin e dispozitës që parashikon një dënim më të butë që kishte hyrë në fuqi pas kryerjes së veprës penale.* ***121. Nga kjo rrjedh se në këtë rast ka pasur shkelje të nenit 7 paragrafi 1 të Konventës.*** *".* Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton se pavarësisht se një dispozitë sikurse është ajo që rregullon procedurën e gjykimit të shkurtuar, citohet në K.Pr.Penale, ajo nuk konsiderohet dispozitë procedurale por konsiderohet materiale pasi përmban rregulla që lidhen me dënimet dhe kohëzgjatjen e saj. Ndodhur në këto kushte, GJEDNJ-ja gjeti shkelje të nenit 7 të Konventës për shkak se nuk ishte zbatuar ligji penale favorizues ndaj kërkuesit Scoppola, por është aplikuar një dënim që rëndon pozitën e tij. Duke u rikthyer në rastin konkret, mbështetur në stadardin e vendosur nga GJEDNJ-ja në **çështjen *Scoppola kundër Italisë***, Gjykata çmon se dispozitat që rregullojnë procedurën e gjykimit të shkurtuar në Republikën e Shqipërisë, konkretisht nenet 403-406 të K.Pr.Penale, duke qenë përmbajnë rregulla lidhur me kohezgjatjen e dënimit, hynë në kategorinë e dispozitave materiale, ku nuk zbatohet parimi sipas të cilit, ligji i ri ka fuqi edhe ndaj marrëdhënieve procedurale të lindura para hyrjes së tij në fuqi, për çështje që gjenden në hetim apo gjykim (*tempus regit actum*), por zbatohet parimi se ligji i ri nuk ka fuqi prapavepruese, me përjashtim të rasteve kur ai është në favor të të pandehurit.

shqiptaria.com

Uniteti i këtij sistemi qëndron në varësinë që ekziston ndërmjet normës "krijuese" dhe normës së "krijuar".[15] Në këtë kuptim, nëse gjyqtari gjatë një gjykimi, arrin në përfundimin se ligji dhe akti nënligjor, të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me zgjidhjen e çështjes, bien në kundërshtim me njëri tjetrin, ai është i detyruar të bazohet në ligj. Gjyqtarët duhet të kenë parasysh dhe raportet ndërmjet ligjeve që miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit (ligje të përforcuara), sipas nenit 81/2 të Kushtetutës dhe ligjeve që miratohen sipas rregullit të përgjithshëm të parashikuar nga neni 78 i Kushtetutës. Kushtetuta i jep ligjeve të përforcuara fuqi të veçantë juridike në krahasim me aktet e zakonshme të ligjvënësit. Për këtë arsye, në hierarkinë e akteve, ato renditen para ligjeve të zakonshme të Kuvendit.[16]. Për rrjedhojë, në rastet e konflikteve ndërmjet normave me fuqi të ndryshme juridike, norma me fuqi më të lartë ka epërsi në raport me normën tjetër (*lex superior derogat inferiori*). Parimet, se norma specifike ka përparësi nga norma e përgjithshme (*lex specialis derogat generali)* dhe se norma që ka hyrë në fuqi më vonë ka përparësi nga norma e mëparshme, nuk veprojnë në raste të tilla.[17] Në rastin konkret, K.Pr.Penale në raport me KEDNJ-në dhe jurispurdencën e GJEDNJ-së në hierarkinë e akteve normative qëndron më poshtë. Prandaj, në rastet e gjykimit në mungesë, Gjykata çmon t'i referohet drejtpërdrejtë standardeve të vendosura në **çështjen *Shkalla kundër Shqipërisë* "Ankimi Nr. 26866/05" GJEDNJ-ja me vendimin e datës 10 Maj 2011**, ku ndër të tjera theksohet se: *"3. Në çështjen në fjalë, Gjykata konstatoi se ishte shkelur rëndë nga autoritetet vendase e drejta e ankuesve për një gjykim të drejtë.* ***Gjykata vëren se kur një ankues është dënuar për shkelje të të drejtave të tij të garantuara në nenin 6 të Konventës, ai duhet, sa të jetë e mundur, të vendoset në pozicionin në të cilin ai do të kishte qenë nëse kushtet e asaj dispozite nuk do të shkeleshin, dhe që në parim, forma më e duhur shqyrtimit, do të gjykohej de novo apo rihapja e procedimeve, nëse kërkohej..",*** dhe **në çështjen *Izet Haxhia kundër Shqipërisë* "Ankimi Nr. 34783/06" GJEDNJ-ja me vendimin e datës 5 Nëntor 2013**, ku ndër të tjera theksohet se: *"82. Megjithëse procedimet e bëra në mungesë të pandehurit nuk janë në vetvete të papajtueshme me nenin 6 të Konventës, gjithsesi* ***mohimi i drejtësisë ndodh pa dyshim kur një person i dënuar në mungesë nuk është në gjendje më pas të përfitojë nga gjykata, e cila ka dëgjuar përcaktimin e tij të ri të meritave të akuzës, si për sa i përket së drejtës ashtu edhe fakteve, kur nuk është përcaktuar se ai ka hequr dorë nga e drejta e tij për t'u paraqitur dhe për t'u mbrojtur vetë ....Gjykata përsërit konstatimet e saj në çështjen Shkalla k. Shqipërisë (nr. 26866/05, §§ 77-79, 10 maj 2011), se kur një ankues është dënuar në shkelje të të drejtave të tij të garantuara nga neni 6 i Konventës, forma më e përshtatshme e ndreqjes do të ishte që sa të jetë e mundur ankuesi të vendoset në pozicionin që do të kishte qenë nëse kjo dispozitë do të respektohej.*** *Forma më e përshtatshme e ndreqjes, në parim, do të ishte gjykimi de novo ose rifillimi i procedimeve nëse kërkohet..".* Kjo për faktin pasi në zbatim të nenit 17 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut. Pra,

[15] *Hans Kelsen*, Reine Rechtslehre (1960), fq.228
[16] Shiko vendimin Nr. 19, datë 03.05.2007 të Gjykatës Kushtetuese.
[17] Shiko vendimin Nr. 2, datë 03.02.2010 të Gjykatës Kushtetuese.

[shqiptarja.com]

standardet e vendosura nga GJEDNJ-ja nëpërmjet jurisprudencën përbën standardin minimum që nuk mund të tejkalohet nga Gjykatat.

8. Sa më sipër u arsyetua, Gjykata vlerëson se nëse pranohet kërkesa për rishikimin e vendimit për një nga shkaqet e parashikuara nga neni 450 pika 1 gërmat "d", "dh", dhe "e" dhe e dërgon çështjen për rigjykim, bën që vendimi për të cilin kërkohet rigjykimit i dhënë në mungesë të të pandehurit, të prishet automatikisht e për rrjedhojë i dënuari tashmë rimerrë statusin e të pandehurit, pasi në vetvete është pranuar se të pandehurit i është cënuar e drejta për një proces të rregullt ligjor. Pra, Gjykata çmon se prishja e vendimit të dhënë në mungesë nuk bëhet në përfundimit të gjykimit të rigjykimit, por që në momentin e pranimit të kërkesës për rishikim sikurse veprohet në rastet e parashikuara nga nenet 428 pika 1 gërma "ç" dhe 432 pika 1 gërma "b" të K.Pr.Penale, **pasi këto janë raste të mirëfillta rigjykimi, ku vlerësohet në dhomë këshillimi nga gjykata e shkallës së parë, ligjshmëria e vendimeve të dhëna në mungesë të të pandehurit nga një tjetër trup gjykues i shkallës së parë apo i gjykatës së apelit**. Çdo interpretim i kundërt do të bënte që 453 pika 4 dhe 456 pika 2 të K.Pr.Penale, të binte në kundërshtim me nenet 31, 33 dhe 42 Kushtetutën dhe nenin 6 dhe 13 të KEDNJ-në, që bën fjalë për respektimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe të drejtën për të pasur një mjet efektiv ankimi, i cili do të garantonte rivendosjes në vend të së drejtës së shkelur. Prandaj, duke arritur në këtë përfundim, Gjykata çmon se në respektim të parimit të shtetit të së drejtës si dhe të parimit të elaboruar nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese se pushteti gjyqësor ushtrohet i shkallëzuar sipas parimit të kontrollit të vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulta nga gjykatat më të larta, bën që pika 1 dhe 3 nenit 453 të K.Pr.Penale nën titullin "**Shqyrtimi i kërkesës",** ku parashikohet shprehimisht se: *"1. Kërkesa e rishikimit shqyrtohet **nga gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin në dhomën e këshillimit**, pa praninë e palëve..... Kur kërkesa pranohet, gjykata vendos dërgimin e çështjes për rigjykim **nga një tjetër trup gjykues i së njëjtës gjykatë** ose në gjykatën e apelit, kur kërkesa është bërë vetëm kundër vendimit të saj**. Kundër vendimit nuk lejohet ankim",** të bien në kundërshtim me nenet 4, 34, 116, 135 dhe 145 të Kushtetutës, pasi prishja dhe dërgimi për rigjykim i një çështje penale mund të bëhet vetëm nga një gjykatë më e lartë.

3. Lidhur me arsyet e antikushtetutshmërisë.

9. Në nenin 4, si dhe në preambulën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë deklarohet parimi i **shtetit të së drejtës**, i cili është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Si i tillë, **ai është një normë e pavarur kushtetuese, prandaj shkelja e tij përbën në vetvete bazë të mjaftueshme për deklarimin e një ligji si antikushtetues**. Ky parim nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike.[18] Në nenin 4, paragrafi i dytë i Kushtetutës deklarohet: "*Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë* ". Deklarimi i epërsisë së Kushtetutës, duke e vendosur në majë të piramidës së normave juridike, përbën një aspekt thelbësor të parimit të shtetit të së drejtës. Ky parim **detyron**

[18]Shiko vendimin Nr. 55, datë 27.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese.

lshqiptarja.com

të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike me të larta, si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material.[19]

10. Neni 4/3 i Kushtetutës parashikon se, **dispozitat kushtetuese zbatohen drejtpërsëdrejti**, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe. Sipas këtij parimi themelor kur rregulli kushtetues parashikohet shprehimisht, ai nuk mund të mënjanohet dhe as të tejkalohet, por duhet të zbatohet drejtpërsëdrejti. **Përjashtimi kushtetues i parashikuar në këtë dispozitë nënkupton se normat kushtetuese mund edhe të mos gjejnë zbatim drejtpërsëdrejti, kur Kushtetuta ka ngarkuar posaçërisht organet shtetërore përkatëse për të nxjerrë ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, me qëllim rregullimin e marrëdhënieve në fusha të ndryshme dhe në përputhje me hierarkinë e normave. Pra, Kushtetuta përmban dispozita që rregullojnë zbatimin e saj në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.** Rregullimet që bën Kushtetuta nuk mund të jenë gjithmonë të plota ose shteruese, pasi ajo nuk ka për qëllim të rregullojë hollësisht çdo çështje të organizimit të jetës politiko-shoqërore të një vendi, por vetëm parimet dhe kriteret bazë mbi të cilat duhet të mbështetet ajo. Edhe pse disa çështje që lidhen me rendin shtetëror mund të parashikohen në mënyrë të hollësishme prej saj, gjithsesi mbeten mjaft aspekte të organizimit të jetës institucionale për t'u parashikuar nga ligje ose akte të tjera normative, sipas rastit.[20] Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka theksuar se nëse ndodhemi përpara një norme ligjore, që nuk mbështetet në parimet dhe rregullimet e specifikuara kushtetuese, por në tejkalime jashtëkushtetuese, si në formë ashtu edhe në përmbajtje, atëherë do të cënohet **parimi i hierarkisë së normave**. Ky është një qëndrim i konsoliduar i Gjykatës Kushtetuese në disa çështje të tjera analoge, në të cilat ka theksuar se *"atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta nuk mund ta bëjë ligji. Prandaj nuk mund të pranohet se ajo ka ometuar pa përmendur raste të tilla ..."*.[21]

11. Respektimi i **hierarkisë së akteve normative** është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor. Parimi i shtetit të së drejtës nënkupton veprimin e të gjitha institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi, si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie dhe në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë ose grup normash, duke përftuar kështu edhe fuqinë e caktuar juridike. Piramida e akteve normative, e sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, përcakton marrëdhëniet midis normave juridike, të cilat bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike. Për rrjedhojë, në rastet e konflikteve ndërmjet normave me fuqi të ndryshme juridike, **norma me fuqi më të lartë ka epërsi në raport me normën tjetër**.[22]

12. **Disa nga elementet e shtetit të së drejtës**, që lidhen me objektin e këtij shqyrtimi kushtetues, janë parimi i ndarjes së pushteteve dhe, i lidhur me këtë parim, **ai i pavarësisë së gjyqësorit**, miratimi i ligjeve në përputhje me Kushtetutën, garantimi i të drejtave dhe lirive

[19] Shiko vendimin Nr. 9, datë 23.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese.
[20] Shiko vendimin Nr. 22, datë 24.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese
[21] Shiko vendimin Nr. 29, datë 09.11.2005 të Gjykatës Kushtetuese.
[22] Shiko vendimin Nr. 16, datë 10.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese

Ishdipteria.com

themelore të njeriut, mbështetja e veprimtarisë së organeve ekzekutive vetëm në ligj, kontrolli i administratës dhe parimi i sigurisë juridike.[23] **Pavarësia e gjyqësorit është një nga shtyllat qendrore të shtetit të së drejtës për shkak të pozicionit që zë dhe rolit që luan gjyqësori në një shoqëri demokratike.[24]** Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj (neni 135, pika 1 i Kushtetutës). Gjykata Kushtetuese ka konfirmuar më parë se gjykatat kanë të drejtën ekskluzive për dhënien e drejtësisë. Ky funksion i gjykatave përcakton vendin e gjyqësorit në sistemin e institucioneve të pushtetit shtetëror dhe statusin e gjyqtarëve Asnjë pushtet tjetër nuk mund të funksionojë si gjykatë dhe të ushtrojë detyrën e gjyqtarit. Askush nuk mund të ndërhyjë në dhënien e drejtësisë apo në dhënien e vendimit për çështje të caktuara. **Askujt nuk i lejohet të vërë në diskutim njohjen dhe vlerën e vendimeve apo të refuzojë zbatimin e tyre, pasi ato kanë marrë formë të prerë**.[25] Ndërkohë në vendimin Nr. 11, datë 02.04.2008 të Gjykatës Kushtetuese, ndër të tjera theksohet se: *"Gjykata çmon se në vendimmarrje, gjyqtarët duhet të jenë të pavarur dhe të aftë të veprojnë pa ndikim të papërshtatshëm, presione, kërcënime ose ndërhyrje, të drejtpërdrejta ose jo, nga kushdo dhe për çfarëdo arsye. Gjyqtarët duhet të kenë liri të plotë për t'i vendosur rastet me paanësi, në përputhje me ndërgjegjen dhe interpretimin e tyre për faktet dhe në zbatim të normave të së drejtës.* ***Gjykata është shprehur, se pushteti gjyqësor ushtrohet i shkallëzuar sipas parimit të kontrollit të vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulta nga gjykatat më të larta. Vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga gjykata më e lartë dhe asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore, <u>për sa kohë ato nuk janë ndryshuar ose prishur nga një gjykatë më e lartë</u>*** *(shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese, nr.11, datë 27.05.2004*)."*.* Lidhur me fuqinë juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, në vendimin Nr. 20, datë 01.06.2011 Gjykata Kushtetuese ndër të tjera thekson se: "***Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i tillë që iu imponon të gjithë organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsyetimit të vendimit të saj. Arsyetimi që përdor Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj ka forcën e ligjit****, ça buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale (Shih vendimin nr. 5 datë 07.02.2001 të Gjykatës Kushtetuese). Nisur nga tagrat që i jep neni 124 i Kushtetutës, roli dhe funksioni i Gjykatës Kushtetuese është që nëpërmjet vendimeve të transformojë dispozitat kushtetuese nga abstrakte-metafizike, në substanciale dhe konkrete, duke i garantuar mbrojtje kushtetuese situatave juridike në të cilat ndodhen individët. Për shkak te vetë formës ekstremisht konçize që kanë dispozitat kushtetuese, nëpërmjet vendimeve, pra interpretimit që bën Gjykata, bëhet e mundur që Kushtetuta të jetë "e gjallë", që do të thotë se Gjykata i përshtatet evolucionit që bëjnë vlerat në vendin tonë, duke garantuar që vlera të reja, të cilat ndoshta nuk ishin në vëmendje të hartuesve të Kushtetutës, të marrin dinjitet, njohje dhe, mbi të gjitha, mbrojtje kushtetuese.* ***Për vetë faktin se norma kushtetuese bëhet realitet gjatë interpretimit, pra gjatë procesit vendimmarrës të Gjykatës, e bën këtë të fundit pa diskutim burim të së drejtës, për më***

[23] Shiko vendimin Nr. 20, datë 11.07.2006 të Gjykatës Kushtetuese.
[24] Shiko vendimin Nr. 20, datë 09.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese.
[25] Shiko vendimin Nr. 11, datë 27.05.2004 të Gjykatës Kushtetuese.

Ishdiplomaria.com

tepër e bën atë një burim parësor të saj, duke pasur parasysh se neni 4 i Kushtetutës parashikon se Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë.*"*. Pra, sipas këtij vendimi, vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë të njëjtën fuqi me Kushtetutën që ka epërsi mbi aktet e tjera normative të parashikuara nga neni 116 i Kushtetutës.

13. Në nenin 145 të Kushtetutës deklarohet se gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve (neni 145, pika 1 i Kushtetutës). Roli i gjyqtarit dhe gjykatave në një shtet të tillë është, që ndërsa ushtrojnë funksionin e drejtësisë, ata duhet të sigurojnë zbatimin e normave të shprehura në Kushtetutë, të ligjeve dhe të akteve të tjera ligjore, të garantojnë shtetin e së drejtës dhe të mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut. Në kuadrin e parimit të kontrollit dhe balancës ndërmjet pushteteve, varësia absolute e gjyqtarit ndaj ligjit është kushti dhe legjitimimi i kësaj pavarësie. Pavarësia e gjyqësorit e presupozon vetëqeverisjen e tij. Kjo vetëqeverisje përfshin edhe organizimin e punës në gjykatë dhe aktivitetet e trupave gjyqësorë. Për këtë qëllim, gjykatat kanë dhe buxhet të veçantë, të cilin e administrojnë vetë (neni 144 i Kushtetutës), duke parashikuar në këtë mënyrë një autonomi në administrimin e financave nga vetë ato.[26] **Pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave është një nga parimet themelore të shtetit demokratik. Nëpërmjet ushtrimit të funksionit të drejtësisë, gjyqtari dhe gjykatat duhet të sigurojnë zbatimin e normave të shprehura në Kushtetutë, në ligje dhe në akte të tjera ligjore, të garantojnë shtetin e së drejtës dhe të mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut.[27]**

14. Në nenin 34 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është parashikuar se: *"Askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër* ***dhe as të gjykohet sërish***, ***me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj***". Në këtë normë kushtetuese janë parashikuar tre nga parimet më të rëndësishme të procedurës penale: *i)* parimi i mos gjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale *(ne bis in idem*) *ii)* parimi i sigurisë ligjore *(res judicata)* dhe *iii)* mundësia e rihapjes së çështjes penale si mundësi shmangie nga parimi i sigurisë ligjore. Kriteri **"e njëjta vepër"** i referohet të njëjtit veprim, sjellje, fakt, vepër penale dhe kualifikim ligjor të tyre, të cilat formojnë bazën e kësaj vepre dhe për të cilin personi është dënuar apo liruar. Në këtë rast, është fjala kur si sjellja ashtu edhe krimi bëhen për të njëjtat fakte të ndodhura në të njëjtën kohë dhe që cilësohen njëlloj nga ligji. Duke u nisur nga interpretimet e mësipërme rezulton se ky parim nuk mund të gjejë zbatim në rastet kur të dy veprat penale nuk kanë elementë të njëjtë. Nëse gjenden elementë të njëjtë parimi *"ne bis in idem"* ndalon çdo dënim tjetër apo procedim të mëtejshëm. Sipas kuptimit të mësipërm, kur me vendim të formës së prerë është vendosur për një çështje, atëhere ajo nuk mund të gjykohet përsëri. Ky rregull është i vlefshëm edhe për të gjitha gjykatat e tjera brenda kufijve të të njëjtit juridiksion. Ideja e parimit *ne bis in idem* nuk qëndron tek zbatimi dy a më shumë herë i të njëjtën normë penale, **por tek mosgjykimi** e mosdënimi **përsëri i subjektit për të njëjtën vepër penale, për të cilën ai është dënuar më parë me një vendim të formës së prerë nga një gjykatë e ligjshme.[28]** Në lidhje me parimin e tretë mundësia e rihapjes së çështjes penale përcaktohet se ai mund të lejohet sipas rregullave të parashikuara në ligj dhe konkretisht në Kodin

[26] Shiko vendimin Nr. 20, datë 09.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese.
[27] Shiko vendimin Nr. 26, datë 24.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese.
[28] Shiko vendimin Nr. 5, datë 08.03.2005 të Gjykatës Kushtetuese.

Ishqiptaria.com

e Procedurës Penale. Në kapitullin e VIII-të "Ankimet", Kreun IV është parashikuar "Rishikimi" si mjet i jashtëzakonshëm për të goditur një vendim përfundimtar, d.m.th. të cilit i kanë shteruar të gjitha mjetet e ankimit. Shmangia nga parimi i sigurisë ligjore nëpërmjet rishikimit në kushtet e parashikuara nga ligji ka si qëllim ndreqjen e gabimit gjyqësor në dhënien e drejtësisë. Në lidhje me këtë çështje GJEDNJ-ja në disa çështje [29],[30] është shprehur se: "*Gjykata vlerëson se kërkesat e sigurisë ligjore nuk janë absolute. Largimi nga parimi justifikohet vetëm nëse një gjë e tillë bëhet e nevojshme nga rrethanat dhe nga karakteri substancial detyrues, ose kur ka arsye serioze legjitime që janë më me peshë se siguria juridike".* Megjithatë, vetë kushtetuta është kujdesur të parashikojë në mënyrë eksplicite që përjashtimisht një person mund të gjykohet sërisht "***kur është vendosur rigjykimi i çështjes <u>nga një gjykatë më e lartë</u>, sipas mënyrës së parashikuar me ligj***". Pra, është parashikuar rezerva ligjore absolute për Kuvendin që të detajojë procedurën e rishikimit, por se kush është gjykata e krijuar me ligj, Kushtetuta ka theksuar se ajo duhet të jetë një gjykatë më e lartë se ajo që ka dhënë vendimin e dënimit, për të cilën kërkohet rigjykimi i çështjes. Ky parashikim Kushtetues është në unitet me dispozitat dhe parimet e tjera kushtetuese siç është parimi se pushteti gjyqësor ushtrohet i shkallëzuar sipas parimit të kontrollit të vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulta nga gjykatat më të larta.[31]

15. Duke u rikthyer në rastin konkret, Gjykata çmon se pika 1 dhe 3 e nenit 453 të K.Pr.Penale, i ndryshuar me Ligjin Nr. 35/2017, nën titullin "**Shqyrtimi i kërkesës",** ku parashikohet shprehimisht se: *"1. Kërkesa e rishikimit shqyrtohet* ***nga gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin në dhomën e këshillimit****, pa praninë e palëve.....* ***Kur kërkesa pranohet, gjykata vendos dërgimin e çështjes për rigjykim <u>nga një tjetër trup gjykues i së njëjtës gjykatë ose në gjykatën e apelit, kur kërkesa është bërë vetëm kundër vendimit të saj. Kundër vendimit nuk lejohet ankim</u>",*** e më konkretisht togëfjalëshi "*nga gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin në dhomën e këshillimit"* sipas pikës 1 dhe togëfjalëshi *"i së njëjtës gjykatë"* sipas pikës 3 kësaj dispozite bie në kundërtim me Kushtetutën, për këto arsye: **së pari**, nuk ka sens ligjik dhe juridik që një trup gjykues i së njëjtës shkallë të prishë dhe të kthejë për rigjykim, një vendim të gjykuar nga një trup gjykues tjetër i së njëjtës shkallë gjykimi apo të një gjykate më të lartë sikurse është ajo e gjykatës së apelit. Kjo bie në kundërshtim me parimin se pushteti gjyqësor ushtrohet i shkallëzuar sipas parimit të kontrollit të vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulta nga gjykatat më të larta parashikuar nga neni 135 i Kushtetutës. **Së dyti,** në nenin 34 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është parashikuar se: *"Askush nuk mund ....* ***të gjykohet sërish****,* ***me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes <u>nga një gjykatë më e lartë</u>, sipas mënyrës së parashikuar me ligj****".* Kjo është një dispozitë që zbatohet drejtpërdrejtë lidhur me faktin se kush është gjykata kompetente për të vendosur për rigjykimin, që sipas kësaj dispozite

[29] Ryabykh kundër Rusisë nr.52854/99, fq.52, ECHR 2003-IX).

[30] Bratyakin kundër Rusisë nr.53203/99, fq.63-68, 15 Dhjetor 2005,

[31] Në vendimin Nr. 78, datë 12.12.2017 Gjykata Kushtetuese ndër të tjera arsyeton se: *"45. Duke vënë edhe një herë theksin në fuqinë detyruese të vendimeve të saj, nga e cila nuk bën përjashtim as kjo Gjykatë, ajo rithekson se* ***jurisprudenca kushtetuese nuk mund të riinterpretohet në një mënyrë të tillë që ndryshon sistemin e vlerave të sanksionuara në Kushtetutë, që mohon pajtueshmërinë e vlerave me njëra-tjetrën, që redukton garancitë mbrojtëse të epërsisë së saj në sistemin juridik, që mohon konceptimin e Kushtetutës si një akt i vetëm dhe sistem harmonik, që redukton garancitë e të drejtave dhe lirive të sanksionuara*** *...në Kushtetutë.".*

Ishqiptaria.com

është gjithmon një gjykatë më e lartë se ajo që ka dhënë vendimin e dënimit për të cilën kërkohet rishikimi i vendimit. Ndodhur në këto kushte, parashikimi ligjor se kompetente për të gjykuar kërkesën për rishikim është gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin në dhomën e këshillimit, bie në kundërshtim me parimin e shtetit të së drejtës, i shprehur me përparësinë e normave të Kushtetutës në raport me normat e tjera ligjore. Ky është një qëndrim i konsoliduar i mbajtur nga Gjykata Kushtetuese, në të cilat ka theksuar se ***"atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta nuk mund ta bëjë ligji".***[32]. Pra, togëfjalëshi ***"****nga gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin në dhomën e këshillimit"* parashikuar në pikën 1 të nenit 453 të K.Pr.Penale si dhe togfjalëshin *"...i së njëjtës gjykatë"* parashikuar në pikën 3 të nenit 453 të K.Pr.Penale, të ndryshuar me Ligjin Nr. 35/2017, bie në kundërshtim me nenin 4, 34, 116, 135 dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

16. Gjykata çmon se neni 453 i K.Pr.Penale nën titullin "**Shqyrtimi i kërkesës"** do të ishte në përputhje me Kushtetutën nëse do të riformulohej e do të kishte këtë përmbajtje: "*1. Kërkesa e rishikimit shqyrtohet në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve nga një gjykatë më e lartë se ajo që ka dhënë vendimin për të cilin kërkohet rishikimi. 2. Kur kërkesa është bërë jashtë rasteve të përcaktuara në nenin 450 ose kur është bërë nga ata që nuk e kanë këtë të drejtë ose kur rezulton haptazi e pambështetur, gjykata vendos mospranimin e saj. 3. Kur kërkesa pranohet, gjykata vendos dërgimin e çështjes për rigjykim nga një tjetër trup gjykues në gjykatën e shkallë së parë ose në gjykatën e apelit, kur kërkesa është bërë vetëm kundër vendimit të saj. Kundër vendimit nuk lejohet ankim".*

4. Lidhur me të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi.

17. Kur Kushtetuta shprehet në nenin 145 të saj se "…***gjykata çmon***…" e ka fjalën për një proces subjektiv hulumtimi intelektual që ndodh në ndërgjegjen juridike dhe në bindjen e brendshme të gjyqtarit dhe jo për vlerësime të zakonshme të zbatimit të ligjit ku gjykata më e lartë legjitimohet të gjykojë sipas rolit të secilës prej tyre. Vlerësimi i çmimit të kujtdo gjyqtari për kushtetutshmërinë e një ligji apo jo është juridiksion ekskluziv vetëm i Gjykatës Kushtetuese dhe asnjë lloj autoriteti tjetër gjyqësor, sikurse neni 145 i Kushtetutës parashikon shprehimisht. Në këtë mënyrë edhe pse ligji nuk e ndalon ankimin e zakonshëm apo të veçantë ndaj vendimit të ndërmjetëm për pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese me qëllim shqyrtimin e kushtetuetshmërisë së ligjit apo jo, ndërkohë që duhet ta bënte që mbas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së vitit 1998, me anë të interpretimit të mësipërm, Gjykata nxjerr konkluzionin se ndaj këtij vendimi nuk lejohet ankim, as i veçantë dhe as i zakonshëm.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 4, 34, 116, 135 dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 68 të Ligjit Nr. 8577, datë 10.02.2000 "*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar,

[32] Shiko vendimin Nr. 29, datë 09.11.2005 të Gjykatës Kushtetuese.

[shqiptarja.com]

VENDOSI:

1. Pezullimin e gjykimit të çështjes me Nr. 687 Akti, me **Kërkues**: Artan Hajri Muça dhe me **Objekt:** Rishikimi i vendimit penal Nr. 1418, datë 02.11.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, derisa të shprehet Gjykata Kushtetuese mbi kushtetutshmërinë e çështjeve të ngritura në këtë vendim.
2. T'i kërkojë Gjykatës Kushtetuese të shfuqizojë si antikushtetues togfjalëshin **"***nga gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin në dhomën e këshillimit"* parashikuar në pikën 1 të nenit 453 të K.Pr.Penale si dhe togfjalëshin *"...i së njëjtës gjykatë"* parashikuar në pikën 3 të nenit 453 të K.Pr.Penale, të ndryshuar me Ligjin Nr. 35/2017, si të papajtueshëm me nenet 4, 34, 116, 135 dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Kundër këtij vendimi nuk mund të bëhet ankim.
4. Urdhërohet sekretaria gjyqësore të kryejë veprimet përkatëse për dërgimin e dosjes në Gjykatën Kushtetuese.

Në Tiranë, sot më datë 06.09.2018 ora 13:50.

GJYQTAR

ERJON BANI

[shqiptarja.com]